



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe të nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), të nenit 7, paragrafi 3, të Ligjit nr. 04/L – 144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), të nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01.nr. 569 të dt. 16.12.2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur me 26 dhjetor 2014 miratoi këtë:

V E N D I M

I. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës, për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim me qira të lokaleve ekonomiko afariste personave fizik/juridik për afat prej 5 vite .

II. Sipas vendimit të cekur në pikën I, prona/t e paluajtshme në vijim do të jepen në shfrytëzim:

Nr. lokalit	Adresa	Nr. parcelës	Sipërf/m2	Vendi
Nr.09	Rr „ Avdullah Bugari “ pn	413/2	15 m2	Rahovec
Nr.05	Rr „ Avdullah Bugari “ pn	413/2	12.80 m2	Rahovec
Nr.10	Rr „ Avdullah Bugari “ pn	413/2	51 m2	Rahovec
Nr.07	Rr „ Avdullah Bugari “ pn	413/2	30 m2	Rahovec
Nr.02	Rr „ Xhelal Hajda – Toni “ pn	644/0	50 m2	Rahovec
Nr.08	Rr „ Avdullah Bugari “ pn	413/2	12.8 m2	Rahovec
Nr.03	Rr „ Xhelal Hajda – Toni “ pn	1355/5	144 m2	Rahovec
Nr.22	Rr „ Xhelal Hajda – Toni “ pn	1355/3	13 m2	Rahovec
Nr.12	Rr „ Avdullah Bugari “ pn	413/2	60 m2	Rahovec
Nr.06	Rr „ Avdullah Bugari “ pn	413/2	30 m2	Rahovec
Nr.14	Rr „ Avdullah Bugari “ pn	413/2	10 m2	Rahovec
Nr.17	Rr „ Avdullah Bugari “ pn	413/2	30 m2	Rahovec
Nr.15	Rr „ Avdullah Bugari “ pn	413/2	30 m2	Rahovec
Nr.04	Rr „ Avdullah Bugari “ pn	413/2	30 m2	Rahovec
Nr.18	Rr „ Xhelal Hajda – Toni “ pn	1355/3	39 m2	Rahovec
Nr. 28	Rr „ Avdullah Bugari “ pn	413/2	12 m2	Rahovec
Nr. 13	Rr „ Avdullah Bugari “ pn	413/2	30 m2	Rahovec
Nr.01	Rr „ Xhelal Hajda – Toni “ pn	1355/3	17.5 m2	Rahovec
Nr.19	Rezervat Shtetërore	1038/2	174/m2- 200m2 sip.jasht.	Xërxe
Nr.20	Rezervat Shtetërore	1039	900/m2	Xërxe

III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën II të këtij vendimi është : **LËSHIMI ME QERA I LOKALEVE EKONOMIKO AFARISTE.**

IV. Afati kohor për dhënien e pronës/ve – lokaleve ekonomiko afariste të cekur në pikën II sipas këtij vendimi është afatëshkurtër në periudhen prej **5 vite.**

V. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatëshkurtër realizohet përmesë ankandit publik.

VI. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë do të rregullohen me kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi i marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në periudhen afatshkurte.

VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset : Komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, Kryetari i Komunës, organi kompetentë për pronë dhe organi kompetentë për regjistrimin e pronës së paluajtshme.

VIII. Me hyrje në fuqi të këtij Vendim shfuqizohet Vendimi 01 Nr. 4241 të datës 31.10.2014.

XI. Ky vendim hyn në fuqi **15 ditë** pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokolit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale si dhe publikimit të tij në ueb faqen e Komunës.

01 Nr. 4859
Rahovec, 26.12.2014

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

 **REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odellenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot. 4859 Më 26.12.2014
Br. prot. 2014
RAHOVEC - ORAHOVAC

 **KRYESUESI I KUVENDIT**

Nahit Elshani